



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

ZYRA E KRYETARIT

01-351-33913/2025

07.10.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe ZKA, merr këtë:

V E N D I M

Për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Caktohet Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Ndërtimi i ures automobilistike nga betoni në fshatin Dugajevë, me operator; Benita Company; Ledioni group Sh.P.K., Gremnik, Klinë, dhe me numër të biznesit; 811561308.**

Me numër të prokurimit: **634-25-5200-5-2-1** dhe me numër të kontratës **86-2025**, plani për implementimin e kontratës është 24 muaj.

Vlera e kontratës është 439.902.54 Euro

I. ANTONIJES SELIMIN Menaxher i kontratës (Udhëheqës i ekipit) caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

ARJETA DODAJ Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

LUMI QERKIMIN Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:

II. Enver Berisha, Drejtor për Drejtorinë e Urbanizmit.

1. **Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës** obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modurit për Menaxhimin të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës.

2. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i kontratës do të:

- a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
- b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë dhe
- c. bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontratës janë:

- a. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimi të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b. Menaxheri i kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyre të prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerr urdhër blerjen;
- d. Pas pranimi të urdhër-blejjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-blejjen dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- e. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f. Të sigurojë që Operatori ekonomik të dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshatshme;

- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimi të punëve, mallrave dhe shërbimeve;
- n. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi dhe
- o. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
- b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit - vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Prokurimit;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës;
- Njësisë së Kërkesës;
- Arkivit të Komunës.

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klinae.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

01 Nr 357-339/3/25

DATE 07.10.2025

KONTRATË NR 86-2025

Numri i kontratës:¹ 634-25-5200-5-2-1/C922

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik Benita Company; LEDIONI GROUP SH.P.K., Gremnik, Klinë, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndertimi i Urës automobilistike nga betoni në fashin Dugajevë me numër identifikues: 634-25-5200-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndertim i ures sipas projektit. Projekti eshte bashkefinansim me MMPHI ku 415,043.00 euro jane te parashikura nga MMPHI ndersa nga Kovendi Komunal Kline pjesa tjeter. Mjetet buxhetore jane te ndara viti 2025 100,000.00 MMPHI Viti 2026 200,000.00 MMPHI Viti 2027 195,000.00 MMPHI dhe Komuna Kline.**

No.	Lot
1	Ndertimi i Urës automobilistike nga betoni në fashin Dugajevë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **439,902.54 €**; katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dy Euro e pesëdhjet e katër Cent.

2.2 Plani dinamik është 24 muaj

2.3 sigurimi i ekzekutimit do të jetë 43.990.25 Euro me validitet: 24 muaj+ 1 muaj= 25 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze të situacioneve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Organi Mbikëqyrës dhe Fature

- Mbajtja e parasë në vlerë 43.990.25 € do të paguhet pas Afatit të garancionit të punimeve mbas 12 muajve pas pranimit të përkohshëm teknik . Kjo mund të paguhet me garancion nëse ekzistojnë mjetet në dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	09.10.2025
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	EMRUSA BYTJA
Pozita:	MEJAXHER
Nënshkrimi:	
Data:	07.10.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

HARTIMIN E PROJEKTIT KRYESOR PËR URËN

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Në çmimi duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe shëllja e produktit në gjendje funksionale. Te gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standardëve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. Kontrollimi dhe evidencimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërimit si dhe përpilimi i planit detajl operativ që lidhet me procesin e ndërimit. Në çmim të tlogaritet edhe kosto eventuale e defektimit me aparaturë elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidencimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërimit dhe në rast dëmtimi të bëhet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtëpiake, rrjeti i ujësjetësif etj) dhe infrastruktura mbiltokësore.

1					
Nr.	POZICIONI	Mësi	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
1.1	Punët përgaditore				
1.1.1	Realizimi i bypass-it dhe planit të menaxhimit të perkohshëm të trafikut gjatë kryerjes së punëve për realizimin e urës	copë	1	500	500
1.1.2	Demolimi i ures ekzistuese, rregullimi i punishtes, pastrimi i terrenit dhe largimi i tyre deri në depoti max. 10km -e percaktuar nga organi mbikqyrës. Vërejtje gjatë demolimit çdo demtim i instalimeve (prone publike apo private) duhet të sëmohet nga punëkryesi si dhe të meren të gjitha masat mbrojtëse/paralajmuese gjatë demolimit.	copë	1	20000	20000
1.1.3	Largimi i kontrolluar i trajeve të parapërgatitur, kontrolli i tyre nga plasaritjet e mundshme të shkaktuara gjatë largimit të trajeve. Kontrolli i klasës së betonit të trajeve të parapërgatitur dhe skanimi i tyre me X-Ray. Në çmim të përfshihet dhe vendosja e tyre perseri në uren e re	copë	5	500	2500
1.1.4	Matjet gjeodezike dhe piketimi i ures në terren.	m'	30.00	200.00	6000
				Total 1.1	29,000.00
1.2	Punët e dheut				
1.2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V për tabanë të themellit, shpatulla dhe shtyllat e urës me makineri. Në çmim hyjnë edhe ngarkimi dhe transporti i dheut deri në depoti.	m³	2300.00	3.00	6,900.00
1.2.2	Furnizimi, barlja dhe shtrirja e gjeotekstilit Typar SF 49	m²	270.00	6.00	1,620.00
1.2.3	Mbushja e nën-bazës së themeleve të shtyllës bregore me zhavor dhe ngjeshja e tij në shtresa prej 60 cm, deri sa të arrihet moduli i ngjeshjes (80 - 100 Mpa) e cila punë duhet të testohet me plakën rrethore për modul të ngjeshjes së tokës (atesti)	m³	130.00	20.00	2,600.00
1.2.4	Mbushja me zhavor (guri i thyer) pas shpatullave me fraksion 0-60 mm dhe 0-31.5 mm nën dhe mbi sotelën kapërcyese si dhe ngjeshja e tij deri në modulën e ngjeshjes (80 - 100 Mpa), ngjeshja bëhet në shtresa prej 30 cm dhe i cili duhet të testohet me plakën rrethore për modul të ngjeshjes së tokës (atesti)	m³	2350.00	8.00	18,800.00
1.2.5	Punimi i drenazhës përreth shpatullave (në çmim hyjnë edhe gypat me diametër Ø200mm dhe zhavori për drenazhim)	m'	30.00	50.00	1,500.00
1.2.6	Mbushja, punimi dhe rregullimi i skarpateve pranë krahëve të shpatullave. Mbushja duhet të bëhet me gurin e thyer dhe ngjeshja bëhet në mënyrë të lehtë në shtresa	m³	525.00	20.00	10,500.00
1.2.8	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V për pilota Ø1000mm me makineri përkatëse. Në çmim hyjnë edhe ngarkimi dhe transporti i dheut deri në depotin mbrojtja e gropës së pilotit me gypa betoni të armuar	m³	190.00	10.00	1,900.00
				Total 1.2	43,820.00
1.3	Punët e betonit				
1.3.1	Furnizimi me material, dhe betonimi i shtresave nën themele nga betoni i thjeshtë i klasës C-12/15 f=20cm	m³	21.80	200.00	4,360.00
1.3.2	Betonimi i piloteve, me klase të betonit C-30/37, konforti specifikimeve të dhëna në projekt.	m³	160.00	150.00	24,000.00
1.3.2	Furnizimi me material, përgaditja e kaluqeve, armimi si dhe betonimi i themeleve, si dhe punimi i hidroizollimit horizontal dhe vertikal i pjeseve anësore themeleve të mureve anësore dhe shtyllave të urës. Themelet do të punohen në brigjet e lumit (themetet e shpatullës) me beton C-30/37. Betoni duhet të jetë jo-ujëpërshkues	m³	210.03	250.00	52,507.74



1.3.3	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i mureve dhe krahëve të shpatullave të urës nga betoni i armuar (hidro betonit) i klasës C-30/37 (në çmim hyjnë betonimi dhe punimi i kallupeve të shtyllave dhe krahëve të shpatullave të urës)	m³	288.18	250.00	72,044.00
1.3.5	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi dhe betonimi i soletës me beton C-30/37 me dimensione sipas detallit në projekt.	m³	46.40	300.00	13,920.00
1.3.7	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i pllakave montazhe për shtigje të këmbësorëve si dhe pllakat kapercyese me beton C-25/30 MPa me dimensione sipas detallit në projekt, si dhe vendosja e tyre në vend.	m³	87.86	170.00	14,936.20
				Total 1.3	181,768.00
1.4	Punët e armaturës				
1.4.1	Punimi i armaturës sipas të gjitha pozicioneve nga plani i detajeve të armimit, armatura e brinjëzuar B500B	kg	82000.00	150	123,000.00
				Total 1.4	123,000.00
1.5	Punët përfundimtare të punimeve të vrazhda				
1.5.1	Mbrojtja (hidroizolimi) i themeleve të veçuara në kontakt me tokën, hidroizolimi bëhet si vijon: - Lyerja e sipërfaqes me bitullit - Hidroizolimi me kondor 4mm (dy shtresa)	m²	250.00	6.00	1,500.00
				Total	1,500.00
1.6	Mbështetësat e soletës kaluese				
1.6.1	Blerja, transporti dhe vendosja e mbështetësve Mbështetësit nga elastomeri -- a=700mm, b=500mm dhe t=12mm	copë	20.00	100.00	2,000.00
1.6.3	Fugat e dilatimit TENSA@MODULAR Type - LR - 2	m	20.00	500.00	10,000.00
				Total 1.6	12,000.00
1.7	Punët për evakuimin e ujërave atmosferik				
1.7.1	Blerja, transporti dhe vendosja e ujëmbledhësit të tipit "Gajger" për evakuimin e ujërave nga soleta kaluese dhe hidroizolimi i urës, për komunikacion të rëndë.	copë	8.00	100.00	800.00
1.7.2	Blerja, transporti dhe vendosja e gypave Ø200 mm për evakuimin e ujërave atmosferik.	m	150.00	4.00	600.00
				Total 1.7	1,400.00
1.8	Hidroizolimi				
1.8.1	Punimi i hidroizolimit në tërësi pllakën e urës dhe shtegun e këmbësorëve ISOVILL P-5-B	m²	293.00	50.00	14,650.00
				Total 1.8	14,650.00
1.4.9	Punët e asfaltit				
1.4.9.1	Blerja, transporti dhe shtrirja e asfalt betonit AB-22 si shtresë mbrojtëse me trashësi t=4 cm. Ketu përfshihet edhe sperkatja paraprake me emulzion 0.5 kg/m².	m²	263.00	14.00	3,682.00
1.4.9.2	Blerja, transporti dhe shtrirja e asfaltit AB-11 si shtresë harkhuese me trashësi t=3cm.	m²	263.00	14.00	3,682.00
1.4.9.3	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 18x24 MB40 M100.	m	40.00	25.00	1,000.00
1.4.9.4	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 8/20 MB40 M100 anash trotuarëve.	m	40.00	10.00	400.00
				Total 1.9	8,764.00
1.4.10	Rrethoja e urës				
1.4.10.1	Transporti dhe vendosja e parrmakut (rrethojës) nga autonjëtet me shufra të çelikut, vendosja e tij dhe përforcimi i tij sipas detallit në projekt me llaq epokid (në çmim hyjnë edhe lyerja me minium në dy shtresa dhe lyerja me ngjyrë në dy shtresa).	m	80.00	50.00	4,000.00
				Total 1.10	4,000.00
1.4.11	Testimi i urës				
1.4.11.1	Testimi i urës me ngarkesa provuese në përputhje me normat teknike për këtë aktivitet.	paushall	1.00	20000.00	20,000.00
				Total 1.11	20,000.00
1.1	Punët përgaditore				29,000.00
1.2	Punët e dheut				43,820.00
1.3	Punët e betonit				181,768.00
1.4	Punët e armaturës				123,000.00
1.5	Punët përfundimtare të punimeve të vrazhda				1,500.00
1.6	Mbështetësat e soletës kaluese				12,000.00
1.7	Punët për evakuimin e ujërave atmosferik				1,400.00
1.8	Hidroizolimi				14,650.00
1.4.10	Punët e asfaltit				8,764.00
1.4.10	Rrethoja e urës				4,000.00
1.4.11	Testimi i urës				20,000.00
				Totali	439,902.00



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-25-5200-5-2-1/C922

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.


3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.



Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord me programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11

Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës së sigurimit, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12

Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13

Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën, dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14

Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përfunduar pjesën e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

